



REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E FINANCAVE

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE**

RAPORTI VJETOR 2013

Tirane, mars 2014

Përmbajtja

MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM.....	3
HYRJE.....	5
ZHVILLIMET KRYESORE DHE ZBATIMI I MASAVE PARANDALUESE.....	5
REFORMA LEGJISLATIVE.....	5
MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE	6
PËRFSHIRJA NË PROJEKTE KONFERENCA.....	7
NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE RAPORTUESE	9
MASAT ADMINISTRATIVE	12
MBLEDHJA, ANALIZIMI E SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT FINANCIAR.....	13
RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE TË DYSHIMTA	13
RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE TË VLERAVE.....	15
ANALIZIMI FINANCIAR DHE REFERIMI NË ORGANET E ZBATIMIT TË LIGJIT	16
BLLOKIMET E PËRKOHSHME.....	19
SEKTORI I ANALIZËS STRATEGJIKE.....	19
TIPOLOGJI	20
BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBETAR.....	24
BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL	24
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.....	25
OBJEKTIVAT PËR VITIN 2014	26

SHKURTIMET

BE	Bashkimi European.
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
DPPPP	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
EGMONT	Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në Botë.
EKA	Ekspert Kontabël i Autorizuar.
FATF	Grupi i Veprimit Financiar.
ILDKP	Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive
KiE	Këshilli i Europës.
MONEYVAL	Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave.
NjIF	Njësi e Inteligjencës Financiare.
NjPH	Njësia e Përbashkët e Hetimit të Krimin Ekonomik dhe Korrupsionit.
OJF	Organizatë Jo Fitimprurëse.
OSBE	Organizata për Bashkëpunim dhe Sigurinë në Europë.
PEP	Person i Ekspozuar Politikisht
PPP/FT	Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.
RAD	Raporti i Aktivitetit të Dyshimtë.
RTV	Raporti i Transaksionit të Vlerave.
SHISH	Shërbimi Informativ Shtetëror.
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
ZKV	Zyrë Këmbimi Valutor.

MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Me ndjenjë të lartë përgjegjësie nga pozitat e Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), prezantoj raportin vjetor të aktivitetit të kësaj drejtorie për vitin 2013, që konsiston në pasqyrimin e punës dhe përpjekjeve, në bashkëpunim ndërinstitucional e ndërkombëtar, të kësaj njësie për parandalim dhe luftë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Gjithashtu nëpërmjet këtij publikimi kemi si qëllim edhe që të tërheqim sa më shumë vëmendjen e subjekteve raportuese, institucioneve brenda dhe jashtë vendit, shoqërisë civile dhe publikut të gjerë, në funksion të marrjes në çdo formë të mundshme të sugjerimeve apo pse jo edhe oponencës ndaj punës dhe veprimtarisë sonë, të cilat krijojnë premisa për përmirësim të mëtejshëm.

Megjithë problematikat e hasura, ky vit është karakterizuar nga një punë dhe përpjekje e vazhdueshme e DPPPP, në drejtim të përmbushjes së detyrimeve ligjore për të mbledhur, analizuar dhe shpërndarë në organet kompetente informacione dhe të dhëna mbi veprimtarinë e pastrimit të produkteve të veprave penale.

Aktiviteti i drejtorisë është fokusuar kryesisht në bashkëpunimin ndërinstitucional me organet kompetente brënda vendit dhe bashkëpunimin ndërkombëtar me njësitë partnere të inteligjencës financiare, shpërndarjes së informacionit tek autoritetet kompetente dhe përmirësimit të legjislacionit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Pavarësisht kësaj veprimtarie, edhe vlerësimi i organizmave ndërkombëtar monitorues ka qenë se është joefikas zbatimi i legjislacionit kundër pastrimit të parave në vend, nisur nga numri i ulët i çështjeve penale të dërguara për gjykim dhe akoma më i ulët numri i dënimeve për këtë veprë penale.

Në funksion të ndikimit për rritje të efikasitetit të zbatimit të legjislacionit kundër pastrimit të parave në vend, DPPPP do intensifikojë përpjekjet për sensibilizim të mëtejshëm të Autoriteteve Mbikëqyrëse për rritje të përputhshmërisë së veprimtarisë së subjekteve ndaj detyrimeve ligjore, si dhe do ndjekë ecurinë e çështjeve të dërguara në agjensitë ligj zbatuese duke bërë edhe oponencën e nevojshme në rastet kur vlerësohet se çështjet nuk janë trajtuar në mënyrë adekuate.

Për vitin 2014 DPPPP do të vijojë punën në funksion të plotësimit të detyrimeve që lindin nga standartet ndërkombëtare të Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF) si dhe nga objektivat strategjik të qeverisë Shqipëtare në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomiko-financiar.

Drejtori i Përgjithshëm

Genti GAZHELI

HYRJJE

Raporti i DPPPP për vitin 2013, përmban një pasqyrë të përmbledhur të aktivitetit të institucionit, duke evidentuar zhvillimet kryesore në lidhje me kapacitetet profesionale dhe teknike, bashkëpunimin me institucionet e përfshira në parandalimin e pastrimit të parave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe angazhimin aktiv në aktivitetet e Komitetit MONEYVAL të Këshillit të Europës, Grupit EGMONT.

Në funksion të përmbushjes së angazhimeve strategjike për luftën ndaj krimit të organizuar dhe terrorizmit, DPPPP ka përqëndruar punën e saj në analizimin e të dhënave të rasteve të dyshimta të lidhura me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, duke informuar në vijimësi organet e zbatimit të ligjit për konkluzionet.

Reforma legjislative ka vijuar të jetë një komponent i rëndësishëm i veprimtarisë institucionale për vitin 2013 dhe një zhvillim të rëndësishëm në këtë drejtim përbën miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë në Tetor 2013 i ligjit “*Për masat kundër financimit të terrorizmit*”, për hartimin e të cili ka pasur një bashkëpunim të ngushtë të ekspertëve brenda dhe jashtë vendit.

Kapacitetet njerëzore në drejtim të analizës dhe teknologjisë së informacionit kanë njohur gjithashtu një zhvillim të mëtjshëm cilësor në kuadrin e projektit të binjakëzimit “*Mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhe strukturat e hetimit të krimeve financiare në Shqipëri*” i mundësuar në sajë të mbështetjes së Delegacionit të Bashkimit Europian në Tiranë.

ZHVILLIMET KRYESORE DHE ZBATIMI I MASAVE PARANDALUESE

REFORMA LEGJISLATIVE

Duke u vlerësuar si një kusht i rëndësishëm harmonizimi ndërkombëtar në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kuadri legjislativ në këtë fushë ka pësuar evolucion të vazhdueshëm.

Bazuar në rekomandimet e Komitetit MONEYVAL të Këshillit të Europës për një përafrim të mëtjshëm të legjislacionit Shqipëtar në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë Ligji Nr. 157/2013 datë 10.10.2013 “*Për masat kundër financimit të terrorizmit*”.

Risite kryesore të ligjit kanë të bëjnë me zbatimin me efektiv të detyrimeve të Rezolutës 1373 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, përmirësimin e mekanizimit të listimit të personave të shpallur si financues të terrorizmit si dhe përcaktimin e procedurave të autorizimit të përdorimit të fondeve të bllokuara.

Në zbatim të nenit 23, të Ligjit në muajin Dhjetor është hartuar dhe i është propozuar për miratim Ministrit të Financave projekt-udhëzimi “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për shpenzimet e lejueshme mbi fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara të personave të shpallur”.

Gjatë këtij viti, në zbatim të ligjit nr. 9258, datë 15.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, DPPPP ka ndjekur në vijimësi ndryshimet që pëson lista sipas vendimeve të Komitetit 1267 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe ka propozuar ndryshimet në VKM nr. 718, datë 29.10.2004, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, ndryshime të miratuara me Vendimet nr. 198, datë 06.03.2013, nr. 327, datë 18.04.2013, nr. 535 datë 27.06.2013 dhe VKM-në nr. 966 datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa në VKM nr. 718, date 29.10.2004, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar.

MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Krijimi i Sektorit të Analizës Strategjike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, bazuar në urdhërin nr.46 dt. 15.04.2013 të Kryeministrit të vëndit, përbën një risi strukturore për vitin 2013.

Trajnimet e Personelit të DPPPP gjatë vitit 2013

Seminaret e trajnimit me institucionet partnere brenda dhe jashtë vendit janë përqëndruar në trajnimet e personelit në kuadrin e projektit të binjakëzimit “Mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhe strukturat e hetimit të krimeve financiare në Shqipëri” si dhe nga programe të tjera trajnimi, si ato me njësitë homologe të inteligjencës financiare.

Në mënyrë të përmbledhur për periudhën Janar-Dhjetor 2013 trajnimet dhe seminarat e kryera nga personeli i DPPPP brenda vendit paraqiten në tabelën nr 1

Tabela Nr. 1

Nr	Lloji i aktivitetit/Programi	Nr. Aktiviteteve	Nr. Pjesëmarrësve
1	Seminare Proj.Binjakezimit IPA 2009	6	20
2	Workshop KE Tek.Informacioni	1	2
3	Seminar organizuar nga ILEA	1	1
4	Workshop Ministria e Drejtësisë Franceze	1	2
5	Workshop Moneyval	1	2
6	Trajnime me TRACFIN	2	14
	Gjithsej	12	41

Ekspertët e DPPPP kanë marrë pjesë dhe në aktivitetet e mëposhtëme të trajnimit të organizuara në nivel ndërkombëtar:


- Trajnim vlerësues të implementimit të Konventës së Këshillit të Europës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”, të organizuar në datat 3-4 tetor 2013 në Armeni;
- Seminar rajonal me temë “Njësitë e Inteligjencës Financiare (FIU), Lufta kundër pastrimit të parave, marrëdhëniet institucionale dhe praktikat më të mira”, të organizuar në datat 23-25 tetor 2013, në Bullgari, i mundësuar më mbështetjen e autoriteteve franceze;
- Trajnim të ekspertëve vlerësues të rekomandimeve të Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (FATF), organizuar nga MONEYVAL në datat 4-8 nëntor 2013, në Francë;

Përdorimi i burimeve buxhetore.

Një nga drejtimet kryesore të punës së Drejtorise ka qenë dhe monitorimi i zbatimit me efektivitet të buxhetit të DPPPP gjatë vitit 2013.

Për këtë qëllim në zbatim të Ligjit 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013” është bërë detajimi i buxhetit sipas programit, është hartuar programi për prokurimet dhe Programi Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2014-2016. Në grafikun nr.1 paraqiten të dhënat buxhetore për periudhën 2010 - 2013.

Grafiku Nr. 1



PËRFSHIRJA NË PROJEKTE KONFERENCA

Projekti i binjakëzimit

Në muajin prill 2013, perfundoi projekti i binjakezimit “Mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhe strukturat e hetimit të krimeve financiare në Shqipëri”. DPPPP së bashku me Prokurorinë e Përgjithshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Agjensinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara ishin

institucione përfituese të këtij projekti i cili synonte forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale në funksion të hetimit të veprave penale në fushën e krimit financiar.



Aktivitet trajnimi i organizuar në kuadrin e projektit të binjakëzimit

Projekti i mundësuar në sajë të mbështetjes së Delegacionit të Bashkimit Europian, kishte një kohëzgjatje dy-vjeçare (2011 – 2013) dhe është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet relevante Spanjolle dhe Bullgare

Konferenca rajonale e Njësive të Inteligjencës Financiare

Në datat 10 dhe 11 Tetor 2013 u mbajt në Durrës Konferenca e 7-të Rajonale e Krerëve të Njësive të Inteligjencës Financiare me temë “*Forcimi i bashkëpunimit kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe lufta kundër korrupsionit në Europën Juglindore*”. Pjesëmarrës të kësaj iniciative rajonale janë NjIF e Bosnjë Hercegovinës, Kroacisë, Malit të Zi, Maqedonisë, Serbisë, Sllovenisë dhe Shqipërisë. Në këtë konferencë ishin të ftuar edhe drejtuesit e NjIF të Kosovës dhe të Greqisë, duke mundësuar në këtë mënyrë zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në rajonin e Ballkanit.

Konferenca u organizua nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) në bashkëpunim dhe me mbështetjen bujare të Prezencës së OSBE në Shqipëri, si dhe asistencës së Shoqatës së Bankave të Shqipërisë. Krahas njësive të inteligjencës financiare të rajonit në të morën pjesë dhe përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme, Policisë së Shtetit, Shoqatës së Bankave, Dhomës Kombëtare të Noterisë, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe përfaqësues të OPDAT, PAMECA IV, INTERFORZA, etj.

Një vlerë e shtuar e këtij aktiviteti ishte pjesëmarrja e Ambasadorit të OSBE në Shqipëri Z. Florian Raunig, Drejtorit të Kabinetit të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore Znj. Eridiana Çano, përfaqësuesit të Delegacionit të BE në Tiranë, për çështjet e drejtësisë dhe punëve të brendshme, Z. Marcello Repici, etj.

Cikël trajnimi

Më datë 30 Shtator 2013, me mbështetjen bujare të Ambasadës Franceze në Tiranë, filloi një cikël trajnimesh me temë “*Mbi luftën kundër pastrimit të parave*”, në të cilin ishin të përfshirë ekspertë të DPPP, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Brëndshme.

Qëllimi kryesor i këtij cikli ka qënë rritja e efikasitetit të bashkëpunimit ndërinstitucional, si dhe përvetësimi i praktikave më të mira Franceze në metodat e hetimit të krimit financiar e atij të pastrimit të produktit të veprave penale në veçanti.

NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE RAPORTUESE

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, DPPP i ka kushtuar vëmendje në rritje ndërgjegjësimit dhe trajnimit të subjekteve të ligjit, nëpërmjet organizimit të takimeve qoftë me subjektet e ligjit, qoftë me autoritetet mbikëqyrëse/liçensuese.

Të dhënat e publikuara në mënyrë periodike në faqen zyrtare të DPPP, kanë ndikuar në informimin e mëtejshëm të subjekteve të ligjit, në funksion të njohjes me kuadrin ligjor; aktivitete, tipologji dhe standartet ndërkombëtare në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; raportet e organizmave ndërkombëtare për Shqipërinë; personat e shpallur si financues të terrorizmit nga Kombet e Bashkuara; listën e FATF për vendet me mangësi strategjike në zbatimin e standarteve, etj.

Në vitin 2013 janë realizuar një sërë trajnimesh të subjekteve të ligjit në bashkëpunim me Njësinë e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (NjMLF), Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare (AMF), Ministrinë e Drejtësisë, Dhomën Kombëtare të Noterëve, Bankën e Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave si dhe me subjekte individuale.

Kategoritë dhe numri i subjekteve të trajnuara në tre vitet e fundit paraqiten në tabelën nr. 2

Tabela Nr. 2

SUBJEKTI	NR. I PERSONAVE TË TRAJNUAR		
	2011	2012	2013
Banka të Nivelit të dytë	94	116	84
Zyra Këmbimi Valutor	182	179	151
Institucione jo bankë	5	50	---
Kompani Lojëra Fati	22	--	15
Shoqëri Ndërtimi	26	--	---
Noterë	44	71	75
Avokatë	--	5	---
Ekspert Kontabël	34	88	63

Shoqëri Sigurimi	6	18	---
Agjensi Udhëtimi	6	--	---
Autoritete Mbikëqyrëse	--	37	13
Shoqëri tregtimi të automjeteve	2	--	---
Zyra Imobiliare	2	--	---
Institute të Pensioneve Private	6	3	---
TOTALI	429	589	401

Trajnimet janë organizuar duke përfshirë të gjithë kategoritë e subjekteve dhe duke kushtuar vëmendje më të veçantë tek kategoritë që paraqesin nivel më të lartë risku.

Inspektimet në vend dhe në distancë

Procesi i mbikqyrjes së subjekteve është i bazuar në një analizë dinamike të nivelit të riskut ndaj të cilit janë të ekspozuar subjekte përfshirë këtu parametrat që kanë të bëjnë me nivelin e zbatimit të detyrimeve ligjore në fushën PPP/FT, përfshirjes potenciale në aktivitete të jashtëligjshme, produktet dhe shërbimet që ofrohen për klientët, aktiviteti në rang kombëtar apo ndërkombëtar.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave në përmbushje të funksioneve të sajë mbikqyrëse, ka synuar të arrijë një ekuilibër efektiv mes inspektimeve në vend dhe në distancë të subjekteve të ligjit, me qëllim që të arrihet një përdorim adekuat i burimeve njërëzore dhe teknike.

Për të siguruar një përmbushje sa më të lartë të detyrimeve të subjekteve gjatë këtij viti DPPP, krahas kontrollit dhe vlerësimit të nivelit të përputhshmërisë përmes inspektimeve në vend dhe në distancë, ka mbajtur takime individuale apo në grup për të gjitha ato subjekte të cilat kanë pasur mungesa në paraqitjen e dokumentacionit apo nivelin e njohjes së kërkesave ligjore.

Përmes inspektimeve është vlerësuar shkalla e përputhshmërisë me ligjin për PPP/FT dhe rëndësi e veçantë i është kushtuar ngritjes dhe funksionimit të sistemit të brëndshëm për analizimin informacionit si dhe dokumentimin e procedurave të ndjekura dhe konkluzionet për ato raste kur ka dyshime për burimin e fondeve apo transaksionet në vlera të larta dhe komplekse, të pajustificuara nga pikëpamja ekonomike.

Në tabelën nr. 3 paraqiten të dhëna të detajuara për inspektimet e realizuara sipas llojit të subjekteve raportuese;

Tabela Nr. 3

Subjektet e Inspektuara	2011		2012		2013	
	Në vend	Në distancë	Në vend	Në distancë	Në vend	Në distancë
Zyra te Këmbimit Valutor	25	111	20	87	2	110
Shoqëri Sigurimesh	3	-	0	3	0	0
Noterë	8	45	6	54	1	19
EKA	14	1	0	45	0	27
Agjenci Udhëtimesh	3	-				
Zyra Imobiliare	1	1	0	2	0	8
Lojëra Fati	10	-	7	45	0	0
Banka	9	-	5	0	7	0
Institucione Jo Bankare	-	1	5	24	0	0
Shoqëri Ndërtimi	13	61	15	4	0	10
Shoqëritë e tregimit te mjeteve motorike	1	-	0	19	0	0
Pensione private	3	-	0	3	0	0
Shoqëri qiradhënie financiare			1			
Metale dhe gurë te çmuar			2			
TOTALI/TOTAL	90	220	58	286	10	174
	310		347		184	

Në 2013, DPPP siç vërehet dhe nga të dhënat statistikore, si pasojë e ndryshimeve strukturore në fillim të vitit 2013, të cilat çuan në reduktimin e numrit të inspektorëve në dy nga tre që kanë qënë në vitet e mëparshme, puna është orientuar drejt inspektimeve të subjekteve në distancë.

Inspektimet e kryera dhe takimet e mbajtura me subjektet e ligjit përveç rritjes së ndërgjegjësimit nga ana e tyre, kanë pasur në vëmendje edhe vlerësimin në mënyrë korrekte të funksionimit të masave parandaluese në subjekte dhe evidentimin e mangësive ku ndër më kryesoret veçojmë ato që kanë të bëjnë me:

- Proçesin e identifikimit të klientëve dhe dokumentacionin përkatës;

- Mos funksionimin e auditit të brendshëm;
- Mos raportim të transaksioneve të kryera në para fizike;
- Evidentimin e analizave të transaksioneve komplekse, në vlera të larta dhe të pajustificuara nga ana ekonomike;
- Sistemin e brendshëm të analizimit të informacionit dhe të sinjalizimeve të bazuara në treguesit dhe tipologjitë përkatëse të përcaktuara nga subjektet;
- Vlerësimin e riskut dhe profilizimin e klientëve sipas kategorive përkatëse.

Kontrolli i zbatimit të kërkesave për marrje të masave parandaluese për pastrimin e parave dhe raportimin në DPPPP nga subjektet e ligjit, bazuar vetëm në inspektimin ndaj tyre, duke marrë në konsideratë numrin e subjekteve raportuese në raport me numrin e inspektorëve, tashmë është e pamjaftueshme.

Një analizë e thellë e të dhënave (numrit të subjekteve sipas kategorive, riskut të pastrimit të parave në kategori e gjeografi të ndryshme subjektsh, numrit të raporteve të dërguara dhe cilësisë dhe tipologjisë së tyre, të dhënave që përftohen nga analiza e rasteve etj.), vlerësimi i përputhshmërisë së subjekteve, bashkëpunimi intensiv e sistematik me autoritetet mbikëqyrëse dhe institucionet shtetërore, të shoqëruara me trajnime, sensibilizim dhe inspektime, ka pritshmëri që të garantojnë rritje progresive të përmbushjes së detyrimeve për masa parandaluese nga subjektet e ligjit.

MASAT ADMINISTRATIVE

DPPPP, përveç bashkëpunimit dhe trajnimit të subjekteve të ligjit, gjatë aktivitetit të saj vjetor ka vijuar gjithashtu kontrollin e zbatueshmërisë së ligjit dhe akteve nënligjore nga ana e tyre. Në këtë kontekst për shkeljet e konstatuara dhe evidentuara janë marrë dhe masat administrative të cilat paraqiten të kategorizuara sipas subjekteve në tabelën nr. 4:

Tabela Nr. 4

Subjekte	Nr. i masave	Vlera e gjobave në LEK
Banka të Nivelit të Dytë	2	8 500 000
Zyra Këmbimi Valutor	6	5 700 000
Noterë	5	1 700 000
TOTALI	13	15 900 000

Masat administrative të dhëna dhe arkëtimet në mënyrë krahasimore me vitet pararendëse paraqiten në tabelën nr. 5:

Tabela Nr. 5

ZERAT	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013
Vendime për Gjoba	26	22	13
Subjekte që kanë arkëtuar vullnetarisht	9	5	7
Shuma totale e vlerës së gjobave	32 667 394	24 800 000	15 900 000
Shuma e vlerës së arkëtuar për gjobat e vitit 2013	14 619 062	7 200 000	10 600 000
Shuma e vlerës së arkëtuar për gjobat e mbartura	5 977 600	11 169 890	6 061 000
Shuma totale a arkëtimit	20 596 662	18 369 890	16 661 000

Nga masat administrative të vendosura gjatë këtij viti, 66 % të vlerës totale të gjobave janë pranuar dhe likuiduar vullnetarisht nga subjektet, kurse për pjesën tjetër ka vazhduar ankimimi në rrugë gjyqësore. DPPPP ka studiuar me vëmendje praktikatat gjyqësore në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të procedimit administrativ, si dhe të unifikimit të praktikave për zbatimin e legjislacionit për PPP/FT nga subjektet.

MBLEDHJA, ANALIZIMI E SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT FINANCIAR

RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE TË DYSHIMTA

Në tabelën nr. 6 paraqiten RAD e raportuara sipas subjekteve, për vitin 2013 krahasuar me 2012:

Tabela Nr. 6

SUBJEKTI	RAD 2012	RAD 2013
Banka	352	420
Shoqëri transfertash	73	45
DPD	30	36
DPT	33	10
Zyra Qëndrore e Rregjistrimit të Pasurive	29	20
Noter	19	15
Zyra Këmbimi Valutor	14	8
ILDKP	2	0
Shoqëri auditimi	0	1
Ekspert kontabël	0	1

Avokat	1	1
Tjetër	2	1
Shoqëri Leasing	1	0
Total	556	558

Në kuadrin e analizimit të informacionit në vijimësi bëhet dhe kategorizimi i tipologjive kryesore të cilat në mënyrë krahasimore me vitin e mëparshëm paraqiten të kategorizuara në tabelën nr. 7

Tabela Nr. 7

Tipologjia e RAD	Viti 2012	Viti 2013
Transferta të dyshimta	218	189
Derdhje me para në dorë në shuma të konsiderueshme	60	96
Përdorimi i llogarisë individuale për qëllime biznesi/evazion fiskal	52	44
Veprime jashtë profilit të klientit	29	60
Dyshime lidhur me aktivitete të import/eksportit të mallrave	19	13
Deklarim/Mos deklarim të vlerave në kufi	11	23
Mashtrim dhe mashtrim kompjuterik	1	4
Përfshirje të PEP në transaksione	9	0
Dyshime për financim terrorizmi	3	4
Sponsorizime/dhurime/dhënie huaje nga/për të tretë	15	18
Blerje pasurish të paluajtshme me burim të panjohur të fondeve	37	29
Blerje pasurish të luajtshme me burim të panjohur të fondeve	7	0
Mos identifikimi i pronarit përfitues	24	1
Veprime të mbetura të tentativë	17	26
Transaksione të kryera nga OJF	5	4
Kryerja e një aktiviteti ekonomik fiktiv	23	5
Transaksione të kryera nga /drejt kompanive të lojërave të fatit	7	2
Veprime nga persona të dyshuar si të përfshirë në veprimtari kriminale	0	9
Përdorimi i instrumenteve bankare me anomali/	5	4

falsifikuar (letër kredi/çek, etj)		
Përdorim i dyshimtë i kredive bankare	3	8
Tjetër	11	19
Total	556	558

- Nga 558 RAD e raportuara, subjektet kanë kërkuar leje nga DPPPP për kryerje transaksionesh për 41 RAD (7.3%).
- Nga 558 RAD 2013 janë dërguar 115 referime në DPPSH (20%) dhe në Prokurori janë dërguar 17 referime (3%).

Në vijim të rekomandimit të bërë në raportin e raundit të IV të vlerësimit të Shqipërisë nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Europës RAD e raportuara i nënshtrohen një procesi kategorizimi të nivelit të prioritetit i cili përdoret gjithashtu dhe në vlerësimet strategjike që ndërmerren nga DPPPP.

RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE TË VLERAVE

Raportimi i transaksioneve të vlerave, si një nga detyrimet e subjekteve raportuese të ligjit për PPP/FT, është mbajtur në vëmendje të vazhdueshme nga DPPPP. Me gjithë ndryshimet në lidhje me mënyrën e kryerjes, prapun dhe afatet e raportimit këto raportime kanë qënë një burim i vyer për veprimtarinë analizuese të DPPPP.

Me ndryshimet e fundit ligjore të vitit 2012, tashmë të gjithë subjektet e ligjit mbartin detyrimin të raportojnë çdo transaksion të kryer në para fizike që i vetëm apo si transaksion i lidhur brënda 24 orëve, tejkalon prapun prej 1 milion lekë.

Në grafikun nr. 2 paraqiten të dhënat e raportimeve të transaksioneve në para fizike për periudhën 2010 – 2013.

Grafiku Nr. 2



Raportimet e transaksioneve në para fizike nga bankat e përbëjnë pjesën kryesore të raportimeve dhe DPPPP i ka kushtuar në vijimësi rëndësi të veçantë lehtësimit të procedurave dhe konsolidimit të mëtejshëm të këtij sistemi, në të cilin raportimet kryhen të gjitha në rrugë elektronike.

Për vitin 2013, është vërejtur një ulje e numrit të raportimeve krahasuar me vitin 2012 e cila vjen si pasojë e reduktimit të periudhës së raportimit të transaksioneve të lidhura nga 72 orë në 24 orë, uljen e përdorimit të parasë fizike në ekonomi të ndikuar edhe nga legjislacioni fiskal dhe ndikimit të krizës ekonomike në vend.

Raportimi nga ana e subjekteve noter është parë me prioritet nga ana e DPPPP, pasi informacioni që disponojnë në një numër të lartë të rasteve është faktor i rëndësishëm gjatë procesit analizues pasi lidhet me aktivitete që kanë një nivel më të lartë risku për pastrim të produkteve të veprave penale

Viti 2013 ka njohur rritje të numrit të raportimeve që vijnë nga noterë, por edhe rritje të numrit të noterëve raportues, kjo e ndikuar edhe nga liçensimet e reja që kanë ndikuar në rritjen e ndjeshme të numrit të noterëve aktiv në vend.

Mangësitë e konstatuara në drejtim të raportimit të aktiviteteve të dyshimta i janë bërë të ditura Ministrisë së Drejtësisë, si autoritet mbikëqyrës dhe liçensues për këto subjekte e gjithashtu dhe Dhomës Kombëtare të Noterëve.

ANALIZIMI FINANCIAR DHE REFERIMI NË ORGANET E ZBATIMIT TË LIGJIT

Në kuadrin e ushtrimit të funksioneve të saj, gjatë vitit 2013 DPPPP ka vazhduar të përpunojë dhe analizojë raportimet e subjekteve të ligjit, si dhe çdo informacion shtesë të marrë prej tyre apo të dhëna të shkëmbyera me organet e zbatimit të ligjit dhe institucionet e tjera shtetërore. Informacioni i detajuar për rastet kur konkludohen dyshime i dërgohet organeve të zbatimit të ligjit dhe tabela nr. 8 pasqyron të dhënat statistikore për numrin e rasteve të dërguara në DPPSH dhe Prokurori, për vitet 2009-2013.

Tabela Nr. 8

viti	2009	2010	2011	2012	2013
Referuar ne Polici	135	137	160	171	248
Referuar në Prokurori	59	64	51	34	35
TOTALI	194	201	211	205	283

Burimet e informacionit për rastet e referuara gjatë vitit 2013 paraqiten në tabelën nr. 9

Tabela Nr. 9

Burimi	DPPSH	Prokurori	Totali	%
RAD (2013 apo vite të tjera)	195	19	214	75.6%
Iniciuar nga DPPP RTV bankare/noter	34	5	39	13.8%
Burime te hapura	2	1	3	1.1%
Kerkesa/Njoftim nga DPPSH / Prokurori	10	1	11	3.8%
Homologet	5	4	9	3.2%
Njoftime	2	5	7	2.5%
Totali	248	35	283	100%

Pavarësisht modelit administrativ DPPP bazuar në burime të hapura apo konfidenciale, ka arritur të përcaktojë lidhjen me veprën e origjinës së produktit kriminal për 87 të rasteve të referuara. Tabela nr. 10 paraqet të dhënat e kategorizuara.

Tabela Nr. 10

Vepra mëmë	DPPSH	Prokurori	Totali
Procedim penal për pastrim parash	2	-	2
Dyshime për financim terrorizmi	1		1
Trafikim të lëndëve narkotike	8	10	18
Trafikim qëniesh njerezore	3	1	4
Evazion i lartë tatimor	25	3	28
Korrupsion	5	2	7
Mashtrim	9	3	12
Falsifikim	4	1	5
Grafitje/vjedhje	1	1	2
Krijim organizate kriminale	1	-	1
Kontrabandë dhe prodhim/shitje e lëndëve të rrezikshme	-	1	1
Kambizëm i palicënsuar	1	-	1
Trafikim i mjeteve motorike	2	-	2
Precedent penal	2	1	3
Nuk përcaktohet	184	12	196
Totali	248	35	283

Për vitin 2013 rezulton se dyshimet më të shpeshta konsistojnë për

- veprën penale të evazionit të lartë tatimor, me 28 raste të referuara;
- trafikimin e lëndëve narkotike, që edhe këtë vit zë një peshë relativisht të rëndësishme me 18 raste të referuara.

Gjatë këtij viti një vëmëndje në rritje i është kushtuar dhe veprave të tjera penale në fushën e mashtrimeve, korrupsionit dhe falsifikimit të dokumenteve.

Kategorizimit sipas veprave të origjinës do të vijojë t'i kushtohet rëndësi e veçantë në të ardhmen për vetë rolin që ky proces ka në analizën strategjike të informacionit, identifikimin e tendencave dhe tipologjive si dhe vlerësimit të riskut të PP/FT në shkallë vendi.

Në tabelën nr. 11 paraqiten të dhënat për informacionin e dërguar sipas prokurorive për periudhën 2009 – 2013.

Tabela Nr. 11

Prokuroria / vitet	2009	2010	2011	2012	2013	Totali
NJPH Tiranë	39	35	14	17	20	108
NJPH Vlorë		6	11	5	2	24
NJPH Fier	3	3	13	1	5	25
NJPH Durrës	1	7	6	5		19
NJPH Korçë	5	2	1			8
NJPH Shkodër	4	1		1	6	12
Prokuroria Krime të Rënda		7	1			8
Prokuroria e Përgjithshme	2	1	1			4
NJPH Gjirokastrë	1	1	2			4
Prokuroria Elbasan			1	3		4
Prokuroria Lushnje		1	1			2
Prokuroria Lezhë	2				1	3
Prokuroria Berat	2					2
Prokuroria Pogradec				1		1
Prokuroria Kurbin					1	1
Prokuroria Sarandë				1		1
TOTALI	59	64	51	34	35	243

Në këtë aspekt i është kushtuar kujdes i shtuar shpërndarje gjeografike të rasteve duke u bazuar në vendin ku dyshohet të ketë ndodhur transaksioni/transaksionet e dyshuar, vendi i origjinës, është ndjekur në disa raste vendbanimi i shtetasve të referuar apo vendndodhja e biznesit përkatës të përdorur për kryerjen e aktivitetit të dyshimtë.

Për këtë arsye ka patur edhe shpërndarje të informacionit në dy institucione njëkohësisht si psh në NJPH dhe DPPSH apo edhe në Prokurorinë e Përgjithshme.

Nga sa vërehet nga statistikat ka një shpërndarje të gjerë në Njësitë e Përbashkëta Hetimore në rrethe.

DPPPP, gjatë vitit 2013 ka vijuar të japë një kontribut të rëndësishëm dhe në kthimin e përgjigjeve për kërkesat për informacion të organeve kompetente (Polici/Prokurori) dhe të dhënat e detajuara për këtë qëllim paraqiten në tabelën nr. 12

Tabela Nr.12

	KERKESAT	PERSONAT /SHOQERI
PROKURORI	192	1162
POLICI	79	726
TOTALI	271	1888

BLLOKIMET E PËRKOHSHME

Për periudhën Janar- Dhjetor, 2013 janë nxjerrë 15 urdhra bllokimi për fonde dhe llogari bankare të dyshuara si të lidhura me aktivitete të jashtëligjshme. Shuma e sekuestruar është 29,890,522.8 Lek, e cila përbën 24.2% të shumës totale të bllokuar prej rreth 123,433,898 Lek. Të dhënat e detajuara të bllokimeve të kryera nga DPPPP, paraqiten në tabelën nr. 13:

Tabela Nr. 13

Periudha	01.01- 31.12.2013
Nr. i urdhrave të bllokimit	15
Të ngrirë në EURO	579 756
Të ngrirë në USD	33 967
Të ngrirë në LEK	38871 358.8
Sekuestruar	202 486 EUR 27 382.8 LEK 15 151 USD

SEKTORI I ANALIZËS STRATEGJIKE

Sektori i Analizës Strategjike dhe Marrëdhënive me Jashtë ka filluar funksionimin në Korrik të vitit 2013 dhe aktiviteti i tij është përqëndruar në analizën e rrezikut të pastrimit të parave

në sektorin e pasurive të paluajtshme, metaleve dhe gurëve të çmuar dhe shkallës së përdorimit të parasë fizike në ekonomi.

Njëkohësisht ky sektor ka luajtur një rol të rëndësishëm në përgatitjen e raportimeve që DPPPP paraqet në kuadrin e monitorimit që i bëhet vendit tonë nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Europës, Grupi EGMONT si dhe grupet e punës së FATF; zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit; vlerësimit të riskut të PP/FT në shkallë vendi; shkëmbimit efektiv të informacionit me NjIF partnere; përkthimin në gjuhën shqipe të praktikave më të mira të FATF, etj.

TIPOLOGJI

Rasti 1 Dyshime për përfitime nga korrupsioni

DPPPP ka marrë informacion në lidhje me një shtetas 'D' i cili ka transferuar një shumë të konsiderueshme nga llogaria e tij në Shqipëri në një llogari jashtë vendit. Burim i deklaruar ishte huaja e marrë nga një shoqëri në vendin tonë (shoqëria 'M').

Duke u ndodhur përballë këtyre transaksioneve të pazakonta u kryen verifikime të mëtejshme për rastin, nga ku rezultoi se:

- Në vitin 2012 ka pasur një transfertë në mbërritje në llogarinë e tij individuale me dërgues shoqërinë 'M' në shumën 50 000 EUR me përshkrim "divident i vitit 2012" dhe në vitin 2013 ka pasur një transfertë tjetër në mbërritje nga kjo shoqëri në shumën prej 250 000 EUR me përshkrim 'kalim fondi në llogarinë e pronarit'.
- Gjithashtu kishte edhe një transfertë tjetër në mbërritje në llogarinë e tij bankare individuale në vitin 2013 me dërgues një person të tretë 'S' në shumën prej 100 000 EUR, pa përshkrim.

U verifikua në lidhje me shoqërinë 'M' dhe rezultoi se kjo shoqëri ishte në pronësinë e shtetasit 'D' (tashmë vetëm pronar dhe jo administrator i shoqërisë) dhe personi i tretë 'S' ishte caktuar në vitin 2012 Administrator i kësaj shoqërie. Nga verifikimet në të dhënat tona rezultoi se:

- Shtetasi 'D' kishte nënshkruar një kontratë huaje me shtetasin 'S' sipas të cilës i merrte hua shumën 500 000 EUR për 12 vjet dhe mënyra e kthimit të huasë do të ishte nga fitimet e realizuara nga shoqëria 'M'.
- Përveç këtyre nga investigimi financiar rezultoi se kishte transferuar edhe 300 000 EUR të tjera drejt llogarisë së tij personale jashtë vendit, të cilat i ishin transferuar nga shtetasi 'S' si përfaqësues i shoqërisë 'M'.

Nga DPPPP u kryen verifikime të mëtejshme në subjektet e ligjit, për shtetasit dhe shoqërinë e përfshirë në këto transaksione:

1. Për shtetasin 'S' nuk rezultonte të dispononte apo të kishte disponuar këto shuma të larta apo të kishte ndonjë burim tjetër të ardhurash në këto vlera.
2. Shoqëria 'M' e krijuar fillimisht nga bashkëshortet e shtetasve 'D' dhe 'S', më pas ka kaluar në pronësinë 100% të shtetasit 'D'. Gjithashtu ka pasur administrator shtetasin 'S' djalin e tij.

Nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për shoqërinë 'M' rezultoi se fitimet që prej krijimit të saj nuk justifikonin transfertat e sipër përmendura, duke qenë në total rreth 60 000 EUR.


3. Për shtetasin 'D' rezultoi se që prej vitit 2006, kishte qenë i punësuar në funksione drejtuese në tre institucione të ndryshme dhe më pas ka dhënë dorëheqjen për t'u shpërngulur jashtë vendit.

Në konkludim të rastit:

Lindin dyshime nga përshtkrimi i mënyrës së kthimit të huasë, nga fitimet e realizuara nga shoqëria 'M', ku huamarrësi zotëron 100% të kuotave, pra fitime ende të pa përfituara dhe ende të parealizuara dhe për rrjedhojë nuk dihet burimi i vërtetë i këtyre fondeve.

DPPPP ka referuar rastin për ndjekje të mëtejshme në organet ligj zbatuese.

SKEMA



RASTI 2

Produkte të siguruara nga fshehja e të ardhurave

DPPPP u informua nga subjektet e ligjit se një subjekt tregtar X, me administrator dhe ortak shtetasin A, kryente transaksione në vlera të larta për të cilat paraqiste dokumente të pazakonta si edhe nuk justifikonte burimin e pasurisë.


DPPPP përveç të dhënave që dispononte në bazën e të dhënave, kërkoi informacion edhe nga subjekte të tjera, nga analiza e të cilave, rezultoi se:

- Shtetasi A kishte krijuar biznesin X, në Maj të vitit 2009 dhe në shtator të vitit 2012 e kishte shitur këtë shoqëri te shtetasja B.
- Shtetasi A në prill të vitit 2011 kishte regjistruar edhe një tjetër biznes Y me objekt të veprimtarisë të njëjtë me shoqërinë e parë X.
- Shtetasi A kryente transaksione financiare përveçse për llogari të shoqërive X dhe Y, edhe si person i autorizuar në llogari të një tjetër shoqërie Z;
- Në ushtrimin e aktivitetit të saj shoqëria X, sipas faturave të deklaruara, blinte mallra nga shoqëritë Y, Z dhe Ω në vlera të larta dhe i shiste te shoqëritë D, E, F, etj.
- Nga analizimi i transaksioneve të kryera në bankë rezultoi se:
 - Shtetasi A (administrator i X dhe Y) kryente depozitime në vlera të larta llogari të shoqërisë X të cilat po në të njëjtën ditë i transferonte në favor të Y, Z dhe Ω për likuidim të blerjeve, shuma të cilat po në të njëjtën ditë tërhiqeshin nga shtetasi A, nga llogaritë e shoqërive Y, Z në veprime të renditura njëra pas tjetrës.
 - Shoqëritë D, E, F, etj. kryenin transferta në favor të shoqërisë X apo edhe Y, shuma të cilat shtetasi A i tërhiqte po në të njëjtën ditë madje po në atë ditë depozitoheshin në llogaritë e shoqërive D, E, F, etj.
- në lidhje me shoqëritë X, Y dhe Z, nga organet kompetente ishte ushtruar kontroll në lidhje me aktivitetin e biznesit të tyre, nga ku rezultoi se këto shoqëri, kishin adresa të rreme, nuk kishin të punësuar dhe nuk kishin kryer asnjëherë aktivitet të mirëfilltë tregtar.

Bazuar në konkluzionet e analizës financiare dhe dyshimeve për ushtrim të aktivitetit fiktiv, FIU dërgoi informacionin e plotë për investigim të mëtejshëm pranë organeve ligjzbatuese.

Treguesit:

- ✚ *Transaksione financiare me anomali.*
- ✚ *Aktivitet fiktiv.*
- ✚ *Blerje me fatura fiktive duke shmangur detyrimet ligjore;*



RASTI 3

Shtetasi shqiptar A, me nënshtetësi të një vendi European, gjatë një viti, ka deklaruar në dalje të Shqipërisë, shuma të larta në vlerë totale prej 250 000 USD. Qëllimi i deklarimit të këtyre shumave është 'blerje automjeti' dhe 'biznes';

Ky shtetas në sistemin bankar në vend ka qarkulluar prej vitit 2010, shuma të larta kryesisht me para në dorë, ku burimi të ardhurave janë deklaruar, 'kursimet', 'emigracioni', 'marrja borxh' dhe 'biznesi'.

Duke marrë në konsideratë deklaratimet e shumta në pikat e kalimit kufitar dhe qarkullimin e shumave të larta, u kryen verifikime të mëtejshme për rastin, nga ku rezultoi se:

Shtetasi A është i përfshirë në disa biznese në vendin tonë :

Ka regjistruar në 2008 subjektin 'β' shpk, me objekt: 'Blerja, zhvillimi, shitja dhe dhënia me qira e pasurive të paluajtshme, etj'.


Kjo shoqëri është ortakë me 50% në shoqërinë '£' shpk regjistruar në 2009 me të njëjtin objekt veprimtarie. Ortaku tjetër i shoqërisë '£' është shoqëria 'Ω' me përfaqësues një shtetas të huaj. Shoqëria 'Ω' ka ortak të vetëm shoqërinë '@' e cila është e regjistruar në shtetin European ku nënshtetësinë e të cilit mban shtetasi A.

Nga burime të hapura rezultoi se ky shtetas përveç se është i përfshirë në biznese në vendin tonë është i përfshirë dhe në dy biznese në shtetin e sipër përmendur European.

Në vijim (në vitin 2013) shtetasi A, në dalje të Republikës së Shqipërisë, ka deklaruar shumën prej 500 000 USD, me qëllim 'blerje shtëpie' jashtë vendit.

Nga verifikimet e mëtejshme rezultoi se ky shtetas pak kohë më parë, kishte marrë një kredi në këtë shumë në një nga bankat tregtare në vendin tonë të cilën a ka shlyer disa ditë më vonë.

Bazuar në informacionin e analizuar si më sipër, transportimi i shumave të larta jashtë kufirit, përdorimin e dyshimtë të kredisë, përdorimin e shpeshtë të parasë në dorë, etj, informacioni është dërguar për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.



BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBETAR

BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL

Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit dhe Prokurorinë

Një ndër drejtimet kryesore të punës së DPPPP është bashkëpunimi ndër-institucional, pa të cilin nuk mund të ketë sukses lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Aktorët kryesorë të përfshirë në këtë bashkëpunim janë Policia e Shtetit dhe Prokuroria, të cilët marrin referimet e dërguara nga DPPPP. Në vijimësi kemi marrë pjesë në trajnime me përfaqësues të Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë, janë organizuar takime pune dhe komunikimi për çështje të veçanta ka qenë i vazhdueshëm, sidomos me Policinë e Shtetit. Duke aplikuar një qasje proaktive në rastet që kemi ndjekur, ka pasur një vëmendje të shtuar në bashkëpunimin me Policinë së Shtetit dhe Prokurorinë në kuadër të parandalimit të tjetërsimit të pasurive të personave të dyshuar.



Bashkëpunimi ndërinstytucional me Prokurorinë e Përgjithshme

Siç konstatohet nga statistikat, numri i rasteve të referuara nga DPPP për pastrim parash është rritur ndërsa për sa i përket ecurisë së tyre në Policinë e Shtetit apo Prokurori, ende nuk ka një sistem të konsoliduar për ndjekjen e tyre, megjithëse është nënshkruar një marrëveshje për këtë qëllim. Pavarësisht se të dhënat janë të pjesshme e të pa konsoliduara, numri i rasteve të cilat dërgohen në gjykatë për pastrim parash është i ulët dhe akoma më i ulët numri i vendimeve të dënimit. Ky konkluzion është i shprehur edhe në progres-raportin e Komisionit të BE për vendin tonë për vitin 2013.

Bazuar në të dhënat që kemi pasur në dispozicion dhe siguruar me anë të kërkesave të vazhdueshme për ecurinë e rasteve, në mënyrë të vazhdueshme dhe në mënyrë institucionale kemi shprehur qëndrimin tonë mbi mangësitë e konstatuara në trajtimin e rasteve të dyshuara për pastrim parash, qoftë nga Policia e Shtetit apo Prokuroria.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi në kuadrin e grupit EGMONT

Drejtues të DPPP kanë marrë pjesë në mbledhjen plenare të Grupit EGMONT të mbajtur në muajin Korrik në Afrikën e Jugut, në të cilën është paraqitur dhe një tipologji në fushën e pastrimit të parave në kuadrin e konkursit që ky grup zhvillon në baza vjetore.

Bashkëpunimi me Komitetin MONEYVAL të KiE

Gjatë vitit 2013 ekspertë të DPPP kanë marrë pjesë rregullisht në takimet plenare të Komitetit Moneyval të Këshillit të Europës të mbajtura në muajt Mars, Shtator dhe Dhjetor, në të cilat ka dhënë kontributin e duhur në drejtim të procedurave të rritjes së përputhshmërisë për mangësitë e evidentuara në rekomandimet e FATF (R.5, R.6,RS.II dhe RS VIII).

Këto takime kanë një rol të rëndësishëm pasi ndikojnë në njohjen me eksperiencën praktike të vendeve anëtare si dhe angazhimin në projektet konkrete të këtij komiteti në fushën e studimit të tendencave dhe tipologjive në fushën e PPP/FT.

Përfaqësues të DPPPP kanë marrë gjithashtu pjesë në takimet e grupeve të punës së FATF, në kuadrin e monitorimit që ky organizëm i bën vendit tonë si dhe kanë paraqitur në kohë informacionin dhe të dhënat e kërkuara për këtë qëllim.

Shkëmbimi i informacionit me NjIF

Bashkëpunimi ndërkombëtar me NjIF homologe, përbën një komponent të rëndësishëm të punës së Drejtorise se Pergjithshme te Parandalimit te Pastrimit te Parave dhe të dhënat e detajuara statistikore paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela Nr. 14

	Kërkesa		Përgjigje	
	Të dërguara nga DPPPP	Të marra nga Homologët	Të dërguara nga DPPPP	Të marra nga Homologët
Viti 2013	35	56	70	28

Në funksion të rritjes së efektivitetit të kthimit të përgjigjeve për kërkesat e marra nga homologët DPPPP ka synuar që ky proces të kryhet brenda afateve të percaktuara në përputhje me parimet e grupit EGMONT, ndërkohë që rastet të veçanta janë trajtuar më prioritet të lartë.

Në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar gjatë vitit DPPPP ka nënshkruar një Memorandum për shkëmbimin e informacionit me NjIF të Panamasë.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2014

Puna dhe arritjet e DPPPP, që prej krijimit të saj e deri më tani, kanë krijuar premisat e duhura për të përmbushur me sukses funksionin ligjor si njësi e inteligjencës financiare në Shqipëri, si dhe për të zbatuar angazhimet strategjike të ndërmarra nga qeveria Shqipëtare në drejtim të integritetit euro-atlantik të vendit. Në këtë kontekst objektivat kryesorë të punës për vitin 2014 do të jenë:

- Konsolidimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndër-institucional, me agjensitë dhe institucionet e përfshira në parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Analizimi i informacionit të raportuar nga subjektet e ligjit në kuadrin e analizës operacionale, taktike dhe strategjike të informacionit;

- Përfaqësimi dhe angazhimi në aktivitetet e Komitetit MONEYVAL të Këshilit të Europës, Grupit EGMONT dhe FATF;
- Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit me standartet ndërkombëtare të Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar dhe *Acquis Communautaire*;
- Rritja e bashkëpunimit me autoritetet mbikqyrëse/liçensuese të subjekteve të ligjit në drejtim të rritjes së përputhshmërisë së këtyre të fundit me legjislacionin në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Përmirësimi i mëtejshëm i sistemit të të dhënave statistikore në lidhje me praktikën, raportimet nga subjekte të ndryshme, referimet, komunikimin me palë të treta etj;
- Konsolidimi i kapaciteteve njerëzore nëpërmjet aktiviteteve të trajnimit të punonjësve në bashkëpunim me institucionet vendase apo të huaja;
- Verifikimi, analizimi dhe kthimi i përgjigjeve të homologëve në kohë, për një bashkëpunim sa më cilësor dhe frytdhënës;
- Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga dokumentet strategjik në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe hetimit të krimit financiar.